

Број: 02-675/1
06.05.26

PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË NXËNËSVE

Data e mbajtjes: 28.4.2026

Ora: 11:00

Vendi: kabineti i gjuhëve

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.3.2026;
2. Parandalimi dhe njohja e hershme e dhunës;
3. Rishikimi i suksesit dhe notave, sjellja e nxënësve, bashkëpunimi me mësimdhënësit, çështjet aktuale dhe sugjerimet për përmirësimin dhe organizimin e aktiviteteve të ardhshme.

Mbledhjen e udhëhoqi Kryetarja e këshillit të nxënësve, Kristina Krajçeva, në prani të njëzet e dy përfaqësuesve të klasave dhe tre anëtarëve të emëruar nga shërbimi profesional dhe mësimdhënësve: Elena Petrovska, Mimoza Giçevska dhe Halime Demir Horuni. Në fillim të mbledhjes u miratua rendi i ditës dhe më pas procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30.3.2026.

Psikologja Elena Petrovska bëri një prezantim me temë: *Parandalimi dhe njohja e hershme e dhunës*, me qëllim të informimit dhe edukimit të nxënësve. Prezantimi mbuloi konceptet themelore që lidhen me dhunën, format dhe pasojat e saj, si dhe mekanizmat për reagimin dhe njohjen në kohë.

Në lidhje me pikën e tretë, u diskutuan suksesi i arritur i nxënësve, sjellja e tyre gjatë mësimit, si dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit. Çështjet dhe propozimet aktuale u paraqitën me qëllim përmirësimin e procesit mësimor dhe organizimin e aktiviteteve të ardhshme. Kryetarja e këshillit të nxënësve, Kristina Krajçeva, propozoi organizimin e një ekskursioni. Nxënësit njëzëri e pranuan propozimin, duke deklaruar se ekskursioni do të realizohej nëse plotësoheshin kushtet e nevojshme.

Në përfundim, u ra dakord të ndërmerren aktivitete për të përmirësuar suksesin dhe sjelljen e nxënësve, të përforcohet bashkëpunimi me mësimdhënësit, si dhe të shqyrtohen mundësitë për realizimin e ekskursionit dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta në periudhën e ardhshme.

Kryetare e këshillit të nxënësve:

Kristina Krajçeva



Sekretare e përgjithshme:

Angjela Filipoviq



Përktheu:

Jehona Asani


